



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr.18
Prishtinë, më 11.5.2018, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Valentina Bunjaku - Rexhepi, Nezir Çoçaj, Abdyl Salihu, Adem Mikullovc, Arbërie Nagavci, Albulena Balaj - Halimaj dhe Verica Çeraniq.

Munguan: Mufera Shinik dhe Fidan Rekaliu.

Përfaqësues të tjerë: Delegacioni nga shteti i IOWA- së dhe mediat.

Stafi mbështetës i komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Takim me Delegacionin e IOWA- së;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Takim me Delegacionin e IOWA-së

Ismajl Kurteshi, kryetar i komisionit prezantoi para të pranishmëve gjendjen dhe zhvillimet në proceset arsimore në Republikën e Kosovës.

Ai përmendi rezolutën e nxjerr nga Kuvendi lidhur me arsimin me të cilën arsimit vihet si prioritet i Qeverisë dhe vendit. Në pika të shkurta foli lidhur me gjendjen e rëndë të arsimit në përgjithësi, me këtë rast vuri në pah përqindjen e ulët të vijueshmërisë së fëmijëve në arsimin para fillor, si dhe cilësinë jo të kënaqshme në të gjitha nivelet e arsimit. Ai shprehi shqetësimin lidhur me arsimin profesional problemet me punën praktike, si dhe mungesën e teksteve për arsimin profesional. Me këtë rast përmendi edhe largimin e të rinjve nga Kosova në mungesë të punësimit pas përfundimit të studimeve gjendje e cila i detyron ata të shkojnë në vendet perëndimore.

Përfaqësuesja e delegacionit për arsim nga IOWA, Gaëtane Jean - Marie, dekanë e Fakultetit të Edukimit foli lidhur me gjendjen e mësimdhënësve dhe fakulteteve në shtetin e IOWA-së, gjatë katër viteve të studimeve të mësuesisë. Ajo theksoi se mësuesit që përgatiten për një lëndë të caktuar në fakultete, u japin prioritet parapërgatitjes së kësaj lënde, ndërkaq, studentët gjatë studimit në fakultete bëjnë nga 750 orë punë praktike.

Anëtarët e komisionit shtruan një varg pyetjesh lidhur me zhvillimet e arsimit në shtetin e IOWA-së.

Teuta Haxhiu foli lidhur me problemin e nxënësve në shkollat profesionale të cilëve u mungojnë orët praktike, lidhur me këtë tha se interesimi i nxënësve për këto shkolla është i ulët dhe lidhja mes teorisë dhe praktikës për shkollat profesionale mungon, andaj kërkoi ndihmën e shtetit IOWA lidhur me këtë.

Nezir Çoçaj shprehu shqetësimin e tij lidhur me buxhetin e ulët për UP-në duke e vënë në pah mungesën e hulumtimeve dhe kërkimeve shkencore. Me këtë rast falënderoi miqtë nga IOWA, për mundësitë e bashkëpunimit në sfera të ndryshme si në fushën e trajnimeve, konferencat shkencore dhe ato buxhetore.

Arbërie Nagavci tha se përkrahja dhe bashkëpunimi në fushën e arsimit të lartë ka ekzistuar dhe janë bërë reforma të cilat duhej të vazhdohen për përgatitjen e kuadrove për lëndët e caktuara në Fakultetin e Edukimit.

Në fund të takimit, kryetari Kurteshi në emër të komisionit falënderoi përfaqësuesit e IOWA-s për vizitën dhe shkëmbimin e përvojave mes dy shteteve dhe thellimin të bashkëpunimit në vazhdimësi.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës

Ismajl Kurteshi propozoi që të diskutohet lidhur me çështjen e statusit ligjor të Inspektoratit se a do të duhej të jetë inspektorati institucion në kuadër të MASHT-it, apo, agjenci e pavarur në kuadër të qeverisë, ndërsa shqyrtimi dhe amendamenti i këtij projektligji do të shqyrtohet në mbledhjen e radhës.

Në vijim i njoftoi anëtarët me shkresën nga ministri i MASHT drejtuar komisionit lidhur me pikëpamjet për statusin e Inspektoratit të Arsimit, se ndryshimi i statutit të Inspektoratit si agjenci e pavarur, nuk do të rezultojë i suksesshëm nga fakti që ministrisë i hiqen kompetencat që të bëjë zbatimin e politikave deri në nivel shkolle dhe do të jetë e pamundur matja e cilësisë në mësimdhënie. Përveç kësaj MASHT ka deklaruar se me ndryshimin e statusit rrezikohet projekti i ESIP i Bankës Botërore i cili tashmë është në zbatim e sipër dhe në shtator pritet të fillojë vlerësimi i performancës së mësimdhënësve (VPM), si proces i dizajnuar mirë dhe me vegla të avancuara.

Kryetari i njoftoi anëtarët e Komisionin edhe lidhur me takimin me kryetarin e Kuvendit me kryetarët e Komisioneve, ku është njoftuar me Direktivat e Qeverisë dhe të BE-së që të zvogëlohet numri i Agjencive ngase është konstatuar mos funksionimi i mirëfilltë i tyre.

Në vazhdim tha se lidhur me statusin e Inspektoratit duhet të gjendet një model që i njëjti të mos zhvishet nga ministria, e as të formohet si agjenci.

Teuta Haxhiu kërkoi që kjo çështje të diskutohet në mbledhjen e radhës pas takimit me ministrin, dhe se nga praktikatat e deritashme agjencitë nuk kanë treguar një performancë të mirë dhe se jemi për një kontrollim dhe matje të performancës pa ndikim politik.

Nezir Çoçaj the se qëllimi është të ngritet niveli i përgjegjësive dhe funksionimi i Inspektoratit duhet të jetë vetëm në formë të Agjencisë së pavarur, ku do të ketë një arsim cilësor larg ndikimit të politikave. Ai tha se praktikatat e arsimit cilësor kanë treguar se funksionimi i inspektoratit duhet bërë sipas standardeve dhe duhet caktuar prioritetet, dhe lënia e Inspektoratit në kuadër të MASHT është gabim pasi ministria mund të ndikojë në kontrollin e tij.

Albulena Balaj –Halimaj tha se agjencitë sipas praktikave të deri tashme nuk kanë treguar ndonjë rezultat të mirë, andaj edhe ndryshimi i funksionit apo statutit të Inspektoratit do të ndikonte negativisht në rolin e ministrisë për kontrollimin për matjen e cilësisë në mësimdhënie.

Valentina Bunjaku – Rexhepi tha se Inspektorati si Institucion do duhej të jetë në kuadër të Ministrisë së Arsimit ku dhe do duhej të jap llogari për punën e vet, ndërsa tha se agjencitë e pavarura deri më tani nuk kanë treguar ndonjë sukses apo performancë në punën e tyre.

Arbërie Nagavci në diskutimin e saj tha se çështja e statusit të Inspektoratit krijon një dilemë e cila duhet të zgjidhet në mënyrë që nga Institucioni i Inspektoratit të priten rezultate konkrete e të kërkohet llogaridhënie, si dhe të bëhet një vlerësim i performancës edhe për vetë inspektorët.

4. Të ndryshme

Ismajl Kurteshi tha se si komision kemi marrë vendim që të formohen grupe punuese për monitorim të dy ligjeve.

Për monitorim të Ligjit për Sponsorizimet në fushën e Kulturës Rinisë dhe Sportit u formua grupi punues në këtë përbërje:

Teuta Haxhiu- kryesuese e grupit- anëtarë:

Nezir Çoçaj

Adem Mikullovc

Fidan Rekaliu

dhe Albulena Balaj- Halimaj.

Për monitorim të Ligjit për Trashëgiminë Kulturore të Kosovës u formua grupi punues në këtë përbërje:

Ismajl Kurteshi- kryesues i grupit- anëtarë:

Arbërie Nagavci

Valentina Bunjaku –Rexhepi

Abdyl Salihu

dhe Teuta Haxhiu.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Ismajl Kurteshi